



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivered		02.02.2024 9 viti god. year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHEK	681/2024		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1540/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1540/2023, të datës 20.12.2023 të ankuesit me adresë banimi:

kundër Vendimi KA.nr.41/2023 i datës 21.11.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.02.2024, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1540/2023 e datës 20.12.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet ne fuqi Vendimi KA.nr.41/2023 i datës 21.11.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i cila sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit për pozitën “Zëvendës Administrator i Prokurorisë” në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 20.12.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar dhe protokolluar me numër 7567/2023, kundër Vendimit KA.nr.41/2023 i datës 21.11.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Në bazë të provave të lëndës, ankuesja është përfshirë në fazat e procedurës konkretisht listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e cekur më lartë sipas Renditjes përfundimtare të kandidatëve, ankuesja është renditur i dyti me gjithsej 74.1 pikë, ndërsa sipas Njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare të datës 04.10.2023, ankuesi nuk rezulton të jetë kandidate e suksesshme.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Komisioni i Pranimit ka zbatuar gabimisht dispozitat e aplikuara ligjore me rastin e vlerësimit të biografisë së kandidatit fitues pasi që e njëjta përvojën e punës nuk e ka në fushën në të cilën zhvillohet procedura, me kërkesën që konkursi i kontestuar të anulohet për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 29.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshilli Prokurorial i Kosovës. Ndërsa me datë 10.01, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7567/2023 të datës 20.12.2023 të parashtruar nga ankuesi Vendimin e datës 21.11.2023 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e datës 02.11.2023 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Listën e pagave të datës 01.11.2023; Njoftimin e datës për përzgjedhjen përfundimtare të datës 04.10.2023; Rezultatet e testi me shkrim të datës 26.09.2023; Njoftimin e datës 11.08.2023 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore; Rezultatet e testi me shkrim të datës 01.08.2023; Diplomën e Fakultetit Juridik të datës 06.04.2012; Vendimin nga Këshilli Prokurorial të Kosovës të datës 03.02.2023; Vendimin nga Këshilli Prokurorial të Kosovës të datës 17.05.2023; Vendimin nga Këshilli Prokurorial të Kosovës të datës 16.08.2023; E-malin e datës 21.12.2023 nga për E-malin e datës 03.02.2023 nga per E-malin e datës 05.11.2023 nga për me korrespondencë dy faqe; Certificate nga Instituti i Kosovës për Administrata Publike; Certificate nga Instituti Gjyqësor i Kosovës; Certificate nga Akademia për Drejtësi; Certificate të datës 29.04.2016; Përgjigjen në ankesë të datës 10.01.2024 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës; E-malin e datës 03.01.2024 nga për ; Ankesën e datës 20.12.2023 të parashtruar nga ankuesi Konkursin e datës 07.09.2023 për Zëvendës Administrator i Prokurorisë; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar të datës 19.09.2023; Njoftimi i kandidateve të përzgjedhur të datës 21.09.2023; Aplikacionin për punësim; Diplomën e Fakultetit Juridik të datës 06.04.2012; Vendimin nga Këshilli Prokurorial të Kosovës të datës 03.02.2023; Vendimin nga Këshilli Prokurorial të Kosovës të datës 17.05.2023; Vendimin nga Këshilli Prokurorial të Kosovës të datës 16.08.2023; Akt emërimit të ankuesit të datës 10.09.2015 ; Akt emërimit të ankuesit të datës 10.09.2014; Certificate për pjesëmarrje në trajnim të datës 11.05.2023; Certificate për pjesëmarrje në trajnim të datës 28.04.2023; Certificate për pjesëmarrje në trajnim të datës 27.04.2019; Certificate nga Instituti i Kosovës për Administrata Publike; Certificate nga Instituti Gjyqësor i Kosovës; Certificate nga Akademia për Drejtësi; Certificate të gjuhës angleze në nivelin elementar ; Certificate nga UNDP; Kopja e letërnjoftimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 18.12.2022; Letër rekomandimit; Letër reference; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 17.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 28.08.2020; Certificate për dënimet penale; Aplikacionin për punësim të datës 12.09.2023

nga Diplomen e Fakultetit Juridik e datës 07.11.2014; Letër njoftimin e ; Akt emërimit e te datës 06.09.2018; Ndryshimin e akt emërimit te datës 01.03.2022; Certifikata për dënimet penale e datës 12.09.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 17.01.2022; Certifikata për dënimet penale; Vërtetimin për përvojën e punës te datës 07.11.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 21.05.2020; ; Formulari për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 28.12.2022; Aplikacionin për punësim te datës 11.09.2023 nga Diplomen e Fakultetit Juridik e datës 30.07.2012; Letër njoftimi i Diplomen e Fakultetit Juridik e datës 27.01.2016; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 15.12.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 28.12.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 28.12.2020; Aplikacionin për punësim te datës 14.09.2023 nga ; Diplomen e Fakultetit Juridik e datës 03.01.2013; Akt emërimit e datës 02.03.2016 e Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 28.12.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 31.12.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 31.12.2020; Certificate e datës 25.04.2018; ; Certificate e datës 31.07.2018; Certificate e datës 19.12.2018; Certificate e datës 16.11.2018; Certificate e datës 19.04.2019 ; Certificate e datës; Certificate mbi dënimet penale e datës 14.09.2023; Letër njoftimi i Rezultatet e testit me shkrim te datës 26.09.2023; Përmbledhja e rezultateve te testit me shkrim 14.09.2023; Përmbledhja e vlerësimeve te intervistës te datës 28.09.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 13.09.2023; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues te datës 29.09.2023; Vendimin e datës 21.11.2023 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e **pabazuar**, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Sekretariati i Prokurorial të Gjyqësor të Kosovës me datë 07.09.2023 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit të pranimit (*brendshëm*) për pozitën "*Zëvendës Administrator i Prokurorisë*" me numër Reference: KPK/ZKPSH/PSRK/PTH/POZ-006 në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, ndërsa bazuar në Renditjen Përfundimtare të kandidatëve konstatohet fakti se ankuesi ka arritur ti mbledh 69.9 pikë duke u renditur i dyti në listë, rrjedhimisht nuk është përzgjedhur si kandidat fitues.

Ankuesi, i pakënaqur me renditjen përfundimtare të kandidatëve, kishte parashtruar ankesë të brendshme me pretendimin ankimor se komisioni përzgjedhës nuk ka qenë i themeluar sipas dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, kandidati i përzgjedhur nuk ka përvojën adekuate për udhëheqës, nuk është i diplomuar ngase i njëjti është i diplomuar në fakultetin ekonomik dhe se e ka Diplomen me 180kredi ndërsa unë me 240kredi, ndërsa Komisioni për Zgjedhjen e kontesteve dhe Ankesave përmes Vendimit me numër KA.nr.41/2023 të datës 21.11.2023 kishte refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja fitues i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara me konkurs sikurse Komisioni Përzgjedhës është themeluar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës duke marr për bazë nenin 7 të saj.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin e shpallur të datës 07.09.2023, për pozitën "*Zëvendës Administrator i Prokurorisë*" në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës të shpallur nga

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë Universitare: Fakulteti Juridik dhe Ekonomik*

- *Përvoja e punës: Se paku pesë (5) vite përvoja pune.*

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me kërkesën e tij për anulimin dhe rishpalljen e konkursit, Kolegji i Këshillit pas analizimit të aplikacionit dhe dokumentacioneve të bashkangjitura të dorëzuar nga kandidati fituese ka konstatuar se kandidati fituese posedon Diplomën e datës 03.01.2013 me numër:2831 përmes të cilët dëshmohet fakti se i njëjti ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik-Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ndërsa sipas aktit të emërimit të datës 02.03.2016 i njëjti është i punësuar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë në pozitën e punës "Zyrtar për Financa", po ashtu posedon formularët e vlerësimit të rezultateve me shkrim për vitin 2020 (*notë mesatare 5-shkëlqyeshëm*), vitin 2021 (*notë mestarë 5-shkëlqyeshëm*) dhe për vitin 2022 (*notë mestarë 3.56-shumë mirë*) dhe po ashtu ka bashkangjitur Çertifikatën e datës 14.09.2023 lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës-Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës përmes së cilës dëshmohet se i njëjti nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ashtu që sikurse u theksua edhe më lartë kandidati në fjalë i ka plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit të datës 07.09.2023 pasi që përvoja e punës është kërkuar të jetë profesionale (*pas diplomimit*), dhe nuk është kërkuar përvojë në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit sikurse kriter i konkursit ka qenë edhe Fakulteti Ekonomik, dhe mbi këtë bazë pretendim ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji i Këshilli ka analizuar edhe përmbajtjen e aplikacioneve të kandidatëve që kanë hyrë në listën e ngushtë duke përfshirë edhe aplikacionin e ankuesit dhe ka gjetur se përveç ankuesit dhe kandidatit të suksesshëm edhe dy kandidatët e tjerë nga lista e ngushtë dhe i kanë plotësuar kriteret e konkursit të datës 07.309.2023 duke përfshirë përvojën e punës profesionale dhe kualifikimin arsimor si dhe kanë plotësuar dokumentacionin sipas kërkesave të konkursit, nga rrjedh se Komisioni i Pranimit më rastin e përfshirjes së ankuesit, kandidatit të suksesshëm dhe të dy kandidatëve të tjerë të lartcekur në listën e ngushtë ka vepruar në pajtueshmëri me 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës".

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit sa i përket themelimit të Komisionit Përzgjedhë nga ana e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial është marrë për bazë deklarata e datës 19.09.2023 e që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit është vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi që neni 7 i saj ka përcaktuar raste që Komisioni i Pranimit mund të mos themelohet sikurse përcaktohet me dispozitat e kësaj rregulloreje, e në rast të pamundësisë duhet marrë për bazë nenin 7 paragrafi 2 sikurse është vepruar në rrethanat e rastit konkret përmes deklaratës së datës 19.09.2023 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të SKPK-së, rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar madje është kundërthënës kur kërkon që në komision të ketë pjesëtar të komunitet përderisa në ankesën e datës 20.12.2023 të parashtruar në Këshill thekson faktin se i



njëti ka qenë duke e ushtruar pozitën e ushtrues të detyrës (pozitë për të cilën është duke u zhvilluar procedura) për shkak që komuniteti serb janë larguar nga institucionet e vendit në veri.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji i Këshillit gjeti se kandidati i suksesshëm nga përmbledhja e vlerësimit të rezultateve të testit me shkrim dhe intervistës me gojë sikurse përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 74.1 pikë ashtu që është renditur i pari në listë, andaj Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ashtu që kandidati me më së shumti pikë nga testimi me shkrim dhe testimi me gojë emërohet në shërbimin civil, dhe duke u mbështetur në konstatimet e dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se proceduar e rekrutimit për pozitën *"Zëvendës Administrator i Prokurorisë"* në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës ku përcaktohet se: *"11.1. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve. 18.1. Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* prandaj ankesa e ankuesit e datës 20.12.2023 e parashtruar në Këshill është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nisur nga konstatimet e dhëna si më lartë ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.41/2023 i datës 21.11.2023, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.5/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore, prandaj si i tillë akti i goditur përmes ankesës së ankuesi është lënë në fuqi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitivin të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1504/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.